

VENDIM
Nr.657, datë 17.10.2005

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMET NR.280, DATË 16.4.2004 “PËR
NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË
DURRËSIT” DHE NR.283, DATË 16.4.2004 “PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË
ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË LEZHËS” TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, SI
DHE PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.284, DATË 16.4.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË
KULLIMIT KRUJË-KURBIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujëtimin dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

A. Në vendimin nr.280, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i vendimit të ndryshohet si më poshtë vijon:

“PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT DURRËS-KRUJË”.

2. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Durrës-Krujë, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.”.

3. Pas shkronjës “f” të pikës 2, të shtohen shkronjat “g”, “gj”, “h”, “i”, “j”, “k” e “l” me këtë përmbajtje:

“g) zona e fushës që kullon me KUL, Thumanë-Borizanë (KRK- 1, KRK-2), me sipërfaqe 2130 ha;

gj) zona e kënetës Borizanë-Thumanë (KRK-3), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 1591 ha;

h) zona e fushës, që kullon me përroin Bardharë (KRK-4), me sipërfaqe 1499 ha;

i) zona e fushës Bacung-Dollakë-Tapizë (KRK-5, KRK-6), me sipërfaqe 3714 ha;

j) zona e fushës Bubq-Mallkuc (KRK-7), me sipërfaqe 2567 ha;

k) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe kanalet e ujërave të larta;

l) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.”.

4. Shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3, të ndryshohen si më poshtë vijon:

“b. 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Durrësit dhe 1 (një) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Krujës;

c. 2 (dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Durrësit dhe 1 (një) përfaqësues nga komunat, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Krujës;

ç) 1 (një) përfaqësues i bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Durrësit dhe 1 (një) përfaqësues i bashkisë, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Krujës.”.

B. Në vendimin nr.283, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i vendimit të ndryshohet si më poshtë vijon:

“PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT LEZHË-KURBIN”.

2. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Lezhë-Kurbin, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.”.

3. Pas shkronjës “e” të pikës 2, të shtohen shkronjat “ë”, “f”, “g”, “gj”, “e” “h”, me këtë përmbajtje:

“ë) zona e fushës së Thumanës (LAK-1), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 8310 ha;

f) zona e fushës, që kullon me KUL, Gjormë-Zhejë, Mamurras-Lumi Drojë dhe KUL, Laç-Milot (LAK-2, LAK-3, LAK-4), me sipërfaqe 1193 ha;

g) zona e fushës, që kullon me KK-1, Shullaz-Fusahë, Milot-Gramëz-ALK (LAK-5), me sipërfaqe 1459 ha;

gj) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe kanalet e ujërave të larta;

h) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.”.

4. Shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3, të ndryshohen si më poshtë vijon:

“b. 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Lezhës dhe 1 (një) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Kurbinit;

c) 2 (dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Lezhës dhe 1 (një) përfaqësues i komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Kurbinit;

ç) 1 (një) përfaqësues i bashkisë, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Lezhës dhe 1 (një) përfaqësues i bashkisë, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Kurbinit.”.

5. Në vendimet nr.280, datë 16.4.2004 dhe nr.283, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave, emërtimi “Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit” të zëvendësohet me “Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.

6. Vendimi nr.284, datë 16.4.2004 i Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Krujë-Kurbin”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha